



**OMBUDSPERSON INSTITUTION in KOSOVO
INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË
INSTITUCIJA OMBUDSPERSONA na KOSOVO**

Address: Agim Ramadani Str. (Ex "Kosovodrv" building), 10000 Pristina, **KOSOVO**
Adresa: Rr. Agim Ramadani (Ish ndërtesa "Kosovodrv"), 10000 Prishtinë, **KOSOVA**
Adresa: Ul. Agim Ramadani (Bivša zgrada "Kosovodrv"), 10000 Priština, **KOSOVO**
Tel: ++381 (0) 38 501 401, 545 303, 540 447, 548 087, Fax: ++381 (0) 38 545 302
e-mail: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org
web site: www.ombudspersonkosovo.org

23 janar 2007

Z. Ardian Gjini
Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr. i Regjistrimit të Përkohshëm 1904/2005

**Ahmet Zabërgja dhe të tjerët
kundër
Komunës së Vushtrrisë**

I nderuari z. Gjini,

Më 22 gusht 2005, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një ankesë, nga e cila kuptohet se parashtruesi i ankesës, si përfaqësues i banorëve të fshatit Ropicë, të Komunës së Vushtrrisë, ankohet për shkak të mosveprimit të organeve kompetente për të parandaluar pasojat e dëmshme që kompania Art Keramik i shkakton atyre në mjedisin ku ata jetojnë, duke zhvilluar aktivitetin ekonomik nëpërmes një ferme të pulave në po të njëjtin fshat.

Më 26 gusht 2005, unë i kam dërguar një letër Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë dhe kam kërkuar informata në lidhje me këtë çështje.

Më 7 shtator 2005, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë dhe është informuar se Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Bujqësi në Komunën e Vushtrrisë do të merren me këtë çështje.

Më 20 tetor 2005 përfaqësuesi i Ombudspersonit ka kontaktuar me z. Besim Dobruna (asistent ekzekutiv në zyrën e Sekretarit të Përhershëm të MMPH-s) nga i cili ka pranuar kopjen e vërtetimit (Nr. 05/2083/1) të datës 22 korrik 2005 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe

pdfMachine - is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Get yours now!

"Thank you very much! I can use Acrobat Distiller or the Acrobat PDFWriter but I consider your product a lot easier to use and much preferable to Adobe's" A.Sarras - USA

gjendet në listat për veprimtari për të cilat kërkohet Pëlqimi Mjedisor për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VMN) prandaj, Art Keramik-ës nuk i nevojitet raporti për VNM dhe MMPH-ja nuk duhet lëshuar Pëlqimin Mjedisor në lidhje me këtë rast.

Më 13 shtator 2005, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) iu ka drejtuar Art-Keramik-ës me rekomandimet përkatëse në lidhje me ndërmarrjen e masave zoohigjenike në fermën e pulave.

Më 26 tetor 2005, përfaqësuesi i Ombudspersonit e ka vizituar ndërmarrjen Art-Keramik dhe fermën e pulave në fshatin Ropicë dhe ka vërejtur se ajo fermë është ndërtuar në pjesën e fshatit Ropicë, të banuar nga banorët, dhe se kjo fermë nuk i ka zbatuar rekomandimet e MBPZHR-së.

Më 4 prill 2006, përfaqësuesi i Ombudspersonit është takuar me z. Besim Dobruna nga i cili ka kërkuar që MMPH të themeloi një Komision i cili në bashkërendim me MBPZHR-në do të inspektojë fermën e pulave në fshatin Ropicë dhe të ndërmarrë masat adekuate në lidhje me këtë çështje.

Më 6 prill 2006, përfaqësuesi i Ombudspersonit është takuar me z. Qazim Kukalaj (Ushtruesi i Detyrës së Sekretarit të Përhershëm në MBPZHR) dhe ka kërkuar që të behët verifikimi, nëse janë përmbushur rekomandimet e dhëna nga MPBZHR-ja në lidhje me këtë rast.

Më 11 janar 2007, Institucioni i Ombudspersonit përsëri ka pranuar disa ankesa të tjera nga banorët e fshatit Ropicë, të cilët ankohen në lidhje me çështjen e lartpërmendur.

Prandaj, duke u bazuar në nenet 4.3 dhe 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit kërkoj nga ju që në pajtim me nenet: 3.3, 3.5, 19.1 dhe 19.2, të Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 2003-01) si dhe nenet: 41.a dhe 42 të Udhëzimit Administrativ Nr. 9/2004 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, të ndërmerrni të gjitha masat e duhura në lidhje me këtë çështje dhe në përputhje me dispozitat ligjore dhe praktikant ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, në mënyrë që të sigurohet një mjedis i sigurt dhe i qetë për banorët e fshatit Ropicë.

Në pajtim me nenet 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/06 mbi Institucionin të Ombudspersonit në Kosovë, do të kishim pasur dëshirë që përgjigjet tuaja mbi çështjen e lartpërmendur t'i kemi sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se më **6 shkurt 2007**.

Me respekt,

Hilmi Jashari
Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

Kopja i dërgohet: z. Qazim Kukalaj, U.D. i Sekretarit të Përhershëm të MBPZHR-së